

V E N D I M
Nr.424, datë 6.8.1993

**PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË POLITIKËS SHKENCORE E TË ZHVILLIMIT
TEKNOLOGJIK DHE RIORGANIZIMIN E KOMITETIT TË SHKENCËS E TË
TEKNOLOGJISË**

Me propozimin e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Këshillit të Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik pranë Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i Politikës Shkencore dhe i Zhvillimit Teknologjik ka këto detyra kryesore:

-Drejton dhe bën politikën shkencore e të zhvillimit teknologjik të përshtatshme për zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit.

-Miraton drejtimet dhe përparësitë e politikës shkencore e të zhvillimit teknologjik dhe programet e kërkimit e zhvillimit kombëtar që lidhen me të.

-Bën vlerësimin periodik të arritjeve të politikës shkencore e të zhvillimit teknologjik.

-Përcakton detyra për organet shtetërore për zhvillimin dhe përdorimin e potencialeve shkencore.

3. Këshilli i Politikës Shkencore dhe i Zhvillimit Teknologjik kryesohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe ka në përbërje të tij kryetarin e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, ministrin e Arsimit, ministrin e Financave dhe të Ekonomisë, ministrin e Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjitike, ministrin e Bujqësisë dhe të Ushqimit, ministrin e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, ministrin për problemet e pushtetit lokal, kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe 5 shkencëtarë të shquar që caktohen nga kryetari i Këshillit të Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik.

4. Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë është organ përgjegjës qeveritar me karakter ndërministror për shkencën e teknologjinë dhe ka këto detyra e kompetenca kryesore:

-Të hartojë e të zbatojë politikën shkencore e teknologjike shtetërore, duke formuluar dhe programet kombëtare përkatëse vjetore e prespektivë të kërkimeve shkencore e teknologjike, si pjesë e programit tërësor të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit, të cilat ia paraqet për miratim Këshillit të Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik.

-Të përgatitë dhe t'ua paraqesë për miratim organeve kompetente propozimet për mënyrat e zhvillimit e përmisimit të sistemeve të drejtimit në aspektet institucionale, financiare e legjislative, për të siguruar një përdorim sa më efikas e racional të potencialeve shkencore të vendit.

-Të studiojë dhe të marrë masa, në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qëndrore, për inkurajimin dhe transferimin e teknologjisë, në mënyrë që ajo të ndikojë në realizimet ekonomike të vendit.

-Të nxitë e mbështetë zhvillimin e privatizimit në veprimtarinë për kërkim e zhvillim, për probleme me interes për shtetin, duke investuar vetë dhe duke nxitur investimet e sektorit privat.

-Të përgatitë, në bashkëpunim me ministrinë e institucionet e tjera qëndrore dhe Akademinë e Shkencave, dhe t'i propozojë Këshillit të Ministrave fondet nga buxheti i shtetit për veprimtarinë për kërkim e zhvillim dhe të bëjë shpërndarjen e këtyre fondeve. Disponon dhe shpërndan fondet për veprimtaritë që mbulon vetë, fondet për projektet mbi baza konkurrimi, fondet për veprimtaritë sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit teknik e shkencor me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe disponon një fond rezerve për veprimtari e projekte të rëndësishme të paparashikuara.

-Të studiojë dhe propozojë rrugët dhe masat për zgjerimin e pjesëmarrjes së vendit në

kooperimin ndërkombëtar në shkencë e teknologji dhe rritjen e ndihmesës së këtij kooperimi në zhvillimin shkencor, teknologjik e ekonomik.

-Të hartojë marrëveshje të bashkpunimit tekniko-shkencor me shtete, qeveri dhe organizata ndërkombëtare dhe t'ia pareqesë ato për shqyrtim ose miratim Këshillit të Ministrave. Në zbatim të këtyre marrëveshjeve harton dhe miraton protokollet e programet e bashkëpunimit teknik e shkencor, si dhe projektet që përmbajnë ato, dhe ndjek zbatimin e tyre.

-Të përfaqësojë Këshillin e Ministrave në organizmat ndërkombëtarë të karakterit shkencor e teknologjik dhe të mbajë lidhje të drejtpërdrejta me organizmat homologe të vendeve të tjera.

-Të inkurajojë përgatitjen dhe kualifikimin e shkencëtarëve të nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë për kërkim e zhvillim dhe për tërë ekonominë.

Në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qëndrore, studion nevojat e ekonomisë dhe të shkencës për specialistë me kualifikim të lartë dhe harton e miraton planet vjetore të kualifikimit e specializimit pasuniversitar, brenda e jashtë vendit, si dhe ndjek zbatimin e tyre.

-Të analizojë e vlerësojë rezultatet e kërkimit shkencor e teknologjik dhe rolin e tyre në zhvillimin e vendit në përgjithësi, veçanërisht veprimtarinë e mbështetura nga vetë Komiteti, si dhe të mbikëqyrë e kontrollojë përdorimin e fondeve nga buxheti i shtetit.

-Të nxitë e mbështetë aktivizimin dhe krijimin e shoqatave e fondacioneve shkencore.

-Nëpërmjet Zyrës së Patentave të regjistrojë e mbrojë patentat, markat tregtare dhe dizajnin industrial në Republikën e Shqipërisë; të nxitë shpikjet e shërbimet e informacionit për patentat, markat tregtare dhe dizajnin industrial.

-Të nxjerrë udhëzime për probleme të ndryshme të veprimtarisë për kërkim e zhvillim të detyrueshëm për ministrinë, institucionet e tjera qëndrore dhe organet e tjera shtetërore.

5. Pranë Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë funksionon Zyra e Patentave. Detyrat e saj përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

6. Pranë Komitetit funksionon Zyra e Programit TEMPUS. Detyrat dhe struktura e saj përcaktohen nga kryetari i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

7. Pranë Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë krijohen dy komisione konsultative: komisioni për shkencat bazë dhe komisioni për shkencat aplikative, të përbëra nga përfaqësues të shquar të shkencës, teknologjisë dhe ekonomisë.

Përbërja e komisioneve dhe detyrat e tyre miratohen nga kryetari i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

8. Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë ka në organikë 40 punonjës. Struktura organizative e tij miratohet nga kryetari i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

Për shtesën në organikën e punonjësve të Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, për vitin 1993, miratohet një fond prej 150.000 lekësh.

9. Qendra e informacionit dhe e dokumentacionit shkencor e teknik e Akademisë së Shkencave kalon në vartësi të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë, si institucion shkencor më vete.

10. Këshilli i Politikës Shkencore dhe i Zhvillimit Teknologjik ka sekretarinë që kryen funksione organizative dhe që emërohet nga kryetari i Këshillit, nga punonjësit e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.212, datë 23.5.1992 "Për detyrat kryesore dhe strukturën organizative të Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ALEKSANDËR MEKSI

